



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 922/1 prot.

Tiranë më 13.8.2020

Lënda: Opinion mbi miratimin e rregullore “Mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimin publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë”

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj, nr. 996 prot., datë 22.07.2020, me anë të së cilës kërkohet opinion lidhur me draftin e “rregullore mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë” (në vijim, “Rregullorja”), të publikuar në: [https://ere.gov.al/doc/Rregullore\\_mbi\\_procedurat\\_e\\_konsultimit\\_public.pdf](https://ere.gov.al/doc/Rregullore_mbi_procedurat_e_konsultimit_public.pdf), në vijim gjeni qëndrimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Referuar vendimit nr. 113, datë 09.07.2020 “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullore mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga enti rregullator i energjisë” të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, në të cilin citohet si referencë Ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Zyra e Komisionerit sugjeron që kjo referencë të shtohet edhe në nenin 1 të Rregullores.

Gjithashtu, vërejmë se në nenin 6 të Rregullores parashikohet se “Çdo projekt akt që miratohet në kompetencë të ERE publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik në faqen zyrtare të internetit të ERE.”

Ndërkohë, në nenin 7 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” parashikohet se “1. Çdo projekt akt publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik. Ky regjistër është një faqe zyrtare interneti, e cila shërben si një pikë qendrore konsultimi, dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Kjo formë siguron dhe

*forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevoja specifike për persona apo grupime të caktuara. 2. Krijimi dhe rregullat e administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës.”*

Rrjedhimisht, sugjerojmë që, pas pikës 1 të nenit 6 të Rregullores, të shtohet edhe një pikë lidhur me publikimin e projektakteve në faqen zyrtare online <https://www.konsultimipublik.gov.al/> të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK).

RENJK është miratuar me Vendimin nr. 828, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike”, i cili është tashmë plotësisht funksional dhe shërben si pikë qendrore konsultimi.

Në lidhje me dispozitat e tjera të Rregullores, Zyra e Komisionerit vëren se ato janë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

